

STATUT I SHOQËRISË

“BIO FARM GRAMSH” shpk

Sot, me datë 03.12.2020, Ortak I vetem themelues:

JULIAN SHYQYRIU, shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur me 05.06.1977, në Gramsh, dhe banues në Tiranë, i pajisur me pasaportë me nr. Personal H706051411 madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, vendosi miratimin e këtij Statuti me termat e mëposhtem:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqëria Tregtare “**BIO FARM GRAMSH**” shpk rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohezgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901, të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, si dhe këtë Statut.

Neni 1

Shoqëria gëzon të drejtën si person juridik, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

Forma e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Kjo shoqëri do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë Statut.

Neni 3

Emerimi Tregtar

Emri Tregtar i Shoqërisë është “**BIO FARM GRAMSH**” sh.p.k. .



Neni 4 Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Tirane, Njesia Bashkiake nr. 4, Rruga Arben Minga, Pallati nr. 65, Kati 1 me nr pasurie 8631/2

Shoqëria me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 Objekti i Veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. Bar-Restorant. Agroturizem per ofrim ushqimi dhe ambjente per qellime pushimi, bujtina, kamping, hotel shendetesore, shoqerore dhe per veprimtari turistike kampingje (kende lodrash, mjedise sportive, shlodhese etj). Bar, restorant, kompleks blegtoral, mbareshtim i gjese se gjalle. Tregtim i gjese se gjalle dhe artikujve bujqesore e blegtorale. Prodhim-perpunim dhe tregtim te produkteve ushqimore dhe blegtorale. Rritje dhe prodhim shpendesh per veze dhe mish, prodhim dhe tregtim ushqimi per blegtorine si dhe çdo aktivitet tjeter tregtar dhe financiar qe i sherben realizimit te objektivit te saj.

Objekti i shoqerise mund te plotesohet e modifikohet ne cdo kohe me miratimin ne perputhje me ligjet perkatese. Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te ngjashem me te.

Neni 6 Kohëzgjatja e shoqerise

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj per nje afat kohor 5- vjecar, Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardollosj shkak. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 7 Kapitali

Kapitali i shoqerise do te jetë 100.000 (njeqind mije) leke, i zoteruar si me poshte:



Nr.	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	JULIAN SHYQYRIU	100%	1

Kapitali është 100% nga kuotat e ortakut të vetem, e ndarë në 1 kuotë.

Ky kapital i përket aksionerit të vetem të shoqërisë. Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi të jete marrë miratimi i ortakëve të tjerë të shoqërisë, duke respektuar të drejtën e parablerjes, kur transferimi bëhet me anë të shitjes.

Kapitali mund të shtohet ose të pakesohet por jo nën vlerën nominale 100.000 leke

Neni 8

DREJTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj Julian Shyqyriu, ortak i vetem dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në mardhënie me të tretet dhe ka kompetencat e plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga përfaqësuesi i paisur me prokurë të posaçme

Neni 9

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetem

Neni 10

Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Të përcaktojë politikën tregtare të shoqërisë;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me eksperte të caktuar prej tij;
- Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 11

Administrimi i shoqërisë

Ortaku I vetem ka te drejte te emeroje nje administrator, financiere, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake

Neni 12 Viti financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

Neni 13 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 14 Të ndryshme

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Statut vlejné dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, pjesa e parë mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t’u administruar në bazë të ligjit, një kopje për tu dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe dykopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

“BIO FARM GRAMSH” SHPK

JULIAN SHYQYRIU

